

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6681
E mërkurë, 17 gusht 2022
çmimi 0.40

Miratohet kërkesa e avokatëve të liderëve të UÇK-së për përgjigje të përbashkët ndaj ZPS-së | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I SHQIPËRISË PËRFUNDON VIZITËN DYDITORE NË KOSOVË

OPOZITA NË KOSOVË I OFRON BASHKËPUNIM PRESIDENTIT TË SHQIPËRISË



Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, pas vizitës në kompleksin e Lidhjes së Prizrenit, ka përmbyllur qëndrimin dyditor në Kosovë. Begaj ka thënë se shpreson që ngjarja e Lidhjes së Prizrenit t'i bëjë të dyja anët e kufirit të mendojnë për vizionin dhe aspiratat që kanë pasur udhëheqësit e asaj kohe dhe t'i kthejnë në realitet në ditët e sotme. Para se ta

përmbyllte vizitën e parë zyrtare në Kosovë, Begaj është takuar me kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi dhe atë të AAK-së, Ramush Haradinaj, por jo edhe me atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku. Krasniqi dhe Haradinaj i kanë ofruar mbështetje të plotë Begajt për avancimin e marrëdhënieve vëllazërore në mes të dy vendeve

AKTUALE



OSMANI IA DORËZOI URDRIN "HERO I KOSOVËS" FAMILJES SË HEROIT SALI ÇEKAJ | F. 6

AKTAKUZË PËR MASHTRIM KUNDËR DHJETË PERSONAVE | F. 6

KMDLNJ: MOSLEJIMI I SHAMISË NË SHKOLLA NUK PARAQET SHKELJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT | F. 6

EKONOMI



FILLON SHPËRNDARJA E PAGESAVE TË SUBVENCIONEVE PËR ÇDO KULTURË BUJQËSORE | F. 7

PRAPË SHKURTIME TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË | F. 7

FAMILJET SHQIPTARE E KANË TË PAMUNDUR BLERJEN E NJË SHTËPIE | F. 7

SPORT

ORARI I GARAVE DHE ÇMIMI I BILETAVE PËR LOJËRAT OLIMPIKE 'PARIS 2024' | F. 9

KALLËZIM PENAL PËR KRIME LUFTE NDAJ NËNKRYETARIT TË KUVENDIT TË SERBISË

FAQE 3



KURTI: 1 SHTATORI DO TË JETË DITË NORMALE

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Finlanda shkurton për 90 % vizat turistike për shtetasit rusë për shkak të luftës në Ukrainë

HELSINKI, 16 GUSHT - Finlanda ka bërë me dije se do ta shkurtojë numrin e vizave turistike që lëshon për shtetasit rusë me 90 për qind për shkak të rritjes së pakënaqësisë mbi luftën në Ukrainë.

Vendimi, i shpallur më 16 gusht nga ministri i Jashtëm Pekka Haavisto, është i fundit në një seri veprimesh nga Finlanda në përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj pushtimit rus të Ukrainës.

Duke folur për mediet në Helsinki, Haavisto ka thënë se që nga data 1 shtator vizat turistike për shtetasit rusë do të jepen në masën e 10 për qind të masës aktuale. "Vizat turistike nuk do të ndalen plotësisht, por numri i tyre do të reduktohet ndjeshëm. Kjo do të thotë se llojet e tjera të vizave - vizitat të afërmit, kontaktet familjare, puna, studimi - do të kenë përparësi dhe do t'i jepet më shumë

kohë", ka thënë ai.

Finlanda aktualisht shqyrton rreth 1000 aplikime për viza në ditë, nga shtetas rusë sipas televizionit publik Yle.

Haavisto ka thënë se Finlanda do ta konsiderojë gjithashtu krijimin e një kategorie specifike të vizave humanitare, e cila mund t'i ndihmojë gazetarët ose punonjësit e OJQ-ve.

Një numër i vogël, por në rritje i vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, kanë bërë publikisht thirrje për kufizimin ose ndalimin e plotë të turistëve rusë në Evropë në përgjigje të luftës. Daniel Speckhard, ish-zyrtar amerikan, aktualisht president i Corus International, një organizatë globale që ofron ndihmë për njerëzit e prekur nga krizat humanitare.

Anëtarët më të gjerë të BE-së, përfshirë Gjermaninë, e kanë



kundërshtuar deri më tani idenë, megjithëse Republika Çeke, e cila mban presidencën e radhës së BE-së, është zotuar të diskutojë më tej për këtë çështje. Pas dekadash qëndrimi dhe mbajtjeje të një statusi neutral, Finlanda ka

nisur shpejt procedurën për anëtarësim në NATO pas pushtimit rus të Ukrainës më 24 shkurt. Edhe Suedia ka vendosur për t'u anëtarësuar dhe aktualisht, 20 nga 30 anëtarët e NATO-s kanë miratuar anëtarësimin e dy

vendeve. "Nuk është e drejtë që qytetarët rusë mund të hyjnë në Evropë, në zonën Shengen, të jenë turistë... ndërsa Rusia po vret njerëz në Ukrainë. Është e gabuar", ka thënë kryeministrja finlandeze Sanna Marin më 15 gusht.

Komandanti amerikan: Raketat e Kinës mbi Tajvan duhet të kundërshtohen

SINGAPOR, 16 GUSHT - Vendimi i fundit i Kinës për të hedhur raketa mbi Tajvan është "gorilla në dhomë" që duhet të kundërshtohet, tha të martën një komandant i lartë ushtarak amerikan. Pekini ka kryer këtë muaj stërvitje të mëdha ajrore dhe detare rreth Tajvanit. Këto stërvitje kanë qenë përgjigje ndaj vizitës të kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së, Nancy Pelosi, në këtë ishull.

Këto stërvitje përfshinin lëshimin e raketave të shumta balistike në ujërat e Tajvanit - disa nga rrugët më të ngarkuara të anijeve në botë - dhe ishte hera e parë që Kina ndërmerri një hap të tillë që nga mesi i viteve 1990. "Është shumë e rëndësishme që ne të kundërshtojmë këtë gjë. Unë e di që gorilla në dhomë po lëshon raketa mbi Tajvan. Nëse ne thjesht e lejojmë që kjo të ndodhë dhe nuk e



kundërshtojmë, ky do të jetë standardi tjetër. Është e papërgjegjshme të hedhësh raketa mbi Tajvan në ujërat ndërkombëtare, ku operojnë korsitë e transportit, ku operon transporti falas", u ka thënë gazetarëve në Singapor komandanti i Flotës së Shtatë, zëvendësadmirali Karl Thomas.

Flota e Shtatë e ka bazën në Japoni dhe është pjesë thelbësore e pranisë së marinës së Uashingtonit në Paqësor.

Gjatë stërvitjeve të këtij muaji media shtetërore kineze ka raportuar se disa nga raketat balistike të lëshuara nga Ushtria Çlirimtare Popullore ndoqën një trajektore direkt

mbi kryeqytetin e Tajvanit Taipei, një përshkallëzim i ri që Pekini nuk e ka konfirmuar.

Partia Komuniste e Kinës nuk e ka drejtuar kurrë Tajvanin, por ajo e konsideron ishullin si territorin e saj dhe është zotuar se një ditë do ta pushtojë ishullin, edhe me forcë nëse është e nevojshme.

Pretendimet për Tajvanin janë bërë më të theksuara nën drejtimin e Xi Jinping. ShBA-ja dhe aleatët e tjerë perëndimorë kanë rritur kalimet e "lirisë së lundrimit" nga anijet detare të ngushticës së Tajvanit dhe Detit të Kinës Jugore për ta përforcuar konceptin se ato dete janë rrugë ujore ndërkombëtare, duke shkaktuar zemërim nga Pekini.

Kina ka thënë se ka kryer stërvitje të reja ushtarake të hënën derisa një delegacion ligjvënësish amerikanë ka vizituar Taipei. Kina dhe Tajvani janë ndarë gjatë luftës civile më 1940. Raportet mes Pekinit dhe Taipeiit janë përkeqësuar veçmas që nga viti 2016, kur Tsai Ing-wen është bërë presidente e Tajvanit me platformën që nuk njeht pretendimet e Pekinit mbi këtë ishull vetëqeverisës.

Ukraina thotë se nga shtatori mund të eksportojë tre milionë tonë drithëra

KIEV, 16 GUSHT - Ukraina mund të eksportojë 3 milionë tonë drithëra nga portet e saj në shtator dhe në të ardhmen mund të jetë në gjendje të eksportojë 4 milionë në muaj, ka thënë të martën zëvendësministri i Infrastrukturës në Ukrainë, Yuriy Vaskov. Ai ka thënë se Ukraina ka pranuar aplikime për 30 anije që do të

eksportin drithëra në dy javët e ardhshme.

Moska dhe Kievi kanë arritur marrëveshje muajin e kaluar për rikthimin e eksporteve të drithërave. Marrëveshja u arrit nën ndërmjetësimin e Turqisë dhe OKB-së dhe kishte synim zhblokimin e tri porteve ukrainase, që ishin bllokuar qëkur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës

më 24 shkurt.

Marrëveshja kërkon që një ekip ndërkombëtar, i përbërë nga zyrtarë nga Turqia, OKB-ja, Rusia dhe Ukraina, t'i mbikëqyrin inspektimet dhe kalimin e anijeve nëpër Bosfor. Javën e kaluar numri i përgjithshëm i anijeve që transportonin drithëra ukrainase kishte shkuar në 16.



Kallëzim penal për krime lufte ndaj nënkryetarit të Kuvendit të Serbisë

PRISHTINË, 16 GUSHT - Organizata joqeveritare "Krimet e Luftës në Gjakovë" më 16 gusht ka dorëzuar në Prokurorinë Speciale të Kosovës në Prishtinë kallëzim penal për krime lufte ndaj tashmë nënkryetarit të Kuvendit të Serbisë, Bozhidar Deliq. Shkëndije Hoda, përfaqësuese e kësaj organizate, ka thënë se kanë mbledhur dëshmi civile për, siç ka thënë ajo, krime që dyshohet se Deliq i ka kryer ndaj civilëve shqiptarë në luftën e fundit në Kosovë. "Në fakt janë tri kallëzime penale të bashkëngjitura me disa dokumentacione faktike, një lloj ditari i operimit të brigadës", ka thënë Hoda. Gjatë luftës në Kosovë në vitin 1999, Bozhidar Deliq ishte komandant i Brigadës së 549 të

ushtrisë jugosllave. Hoda ka thënë se ka besim që organet e drejtësisë do ta kryejnë punën për hetimin e këtyre krimeve, duke marrë për bazë dëshmitë që i ka ofruar kjo organizatë. Sipas përfaqësuesve të organizatës që dorëzoi sot kallëzimin penal, civilë nga rrethi i qytetit të Gjakovës e kanë identifikuar Deliqin si person që "ka kryer krime lufte". Ndryshe Bozhidar Deliq fëmijërinë e hershme e ka kaluar në fshatin e tij të lindjes, Lugbunar të Gjakovës dhe më pas është zhvendosur në Beograd, ku dhe përfundoi akademinë ushtarake. Më 2 gusht anëtarët e Kuvendit serb zgjodhën shtatë nënkryetarë, në mesin e të cilëve edhe Bozhidar Deliq nga



koalicioni NADA (Shpresa). Për zgjedhjen e tij në këtë post kishte reaguar edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pasi ajo ka thënë se Deliqi ka qenë i përfshirë në

luftën në Kosovë. Osmani ka thënë se nënkryetari i sapozgjedhur i Kuvendit të Serbisë ishte "komandant i një brigade ushtarësh që masakruan mijëra kosovarë". "Radio Evropa e Lirë" ka intervistuar banorët e dy fshatrave Tërrnje dhe Landovicë, ku dyshohet që janë kryer krime kundër popullsisë civile shqiptare nga brigada që udhëhiqte Deliq. Ata kanë shprehur mllef dhe zemërim që deri më tani ai nuk është përballur me drejtësinë. Ndërsa Fondi për të Drejtën Humanitare në Beograd, që heton krimet e luftës, ka ngritur dy kallëzime penale kundër Bozhidar Deliqit për ato që ata tha se ishin krime në Kosovë. Deri më tani nuk ka nisur ndonjë proces penal ndaj tij në Serbi.

Kurti: 1 shtatori do të jetë ditë normale



PRISHTINË, 16 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se 1 shtatori do të jetë një ditë normale. Ai është përgjigjur kështu gjatë intervistës për BBC-në në gjuhën serbe, e botuar të martën, kur është pyetur për datën kur pritet të nisë reciprociteti për lëshimin e dokumenteve për hyrje-dalje për shtetasit serbë. Kurti ka thënë se pas 1 shtatorit

ose do të ketë lëshim të dokumenteve siç bën Serbia me shtetasit e Kosovës, ose të dyja vendet do t'i heqin këto dokumente të përkohshme. Vendimi për lëshimin e këtyre dokumenteve që zëvendëson letërnjoftimin është shtyrë për një muaj, me kërkesë të ndërkombëtarëve. "I kam thënë presidentit serb, Aleksandër Vuçiq pranoji dokumentet, më

tha jo se kështu e pranoj pavarësinë e Kosovës. Edhe pse kjo nuk është e vërtetë, pasi edhe Rumania, Sllovakia, Qipro nuk e njohin pavarësinë, por dokumentet e Kosovës, po", ka thënë Kurti. Ai ka folur edhe për targat që Serbia i lëshon në emër të qyteteve të Kosovës. Për këtë, qeveria ka dhënë afat prej dy muajsh për t'i ndërruar.

Raqiq: Quint-i kërkoi nga ne ta pranojmë pavarësinë e Kosovës

PRISHTINË, 16 GUSHT - Kryetari i Listës Serbe, Goran Raqi, ka thënë se ambasadorët e shteteve të QUINT-it, gjatë takimit të mbajtur më 15 gusht në Prishtinë, kanë kërkuar nga kryetarët e komunave me shumicë serbe në Kosovë që "ta pranojnë realitetin, e ai realitet është se Kosova është e pavarur". Këto komente Raqi i ka bërë në një konferencë për medie në qeverinë serbe në Beograd të martën, ku kanë marrë pjesë katër kryetarët e komunave në veri të Kosovës dhe drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe, Petar Petković. Në shtetet e Quint-it bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia e Franca, dhe që të gjitha e njohin pavarësinë e Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008. Raqi ka thënë se në takimin me ambasadorët e Quintit kanë rënë dakord që të mos bëhen publike detajet e takimit, por "për shkak të peshës dhe seriozitetit të mesazhit që morën dje, ne kemi një moral njerëzor dhe përgjegjësi politike për t'i informuar qytetarët që jetojnë në Kosovë. Në takimin

që zgjati më shumë se dy orë, ku kryetarët e komunave i njoftuan ambasadorët për problemet që kanë në komuna... Në atë takim mesazhi kryesor që dëgjuam nga ambasadorët ishin se shtetet e tyre e njohin pavarësinë e Kosovës. Ne, gjithashtu, dëgjuam se ata i mbështetin në mënyrë absolute vendimet e marra nga Prishtina. Veçanërisht ata nënvizuan se i mbështetin vendimet e Prishtinës për targa dhe dokumentin për hyrje-dalje që do t'u lëshohet serbëve me të hyrë në Kosovë", ka thënë Raqi. Raqi ka thënë se ambasadorët e Quint-it thanë se vendimet e Qeverisë së Kosovës për targa dhe dokumentet serbe janë në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit. "Ne absolutisht nuk u pajtuam me ta. Na bën thirrje që ta pranojmë realitetin në terren dhe ai realitet është që Kosova është e pavarur. Asnjë serb, dhe ne ua thamë qartë dje, nuk e pranon atë pavarësi dhe nuk do ta pranojë kurrë. Ne po shikojmë Brukselin, presidentin tonë Aleksandër Vuçiq dhe po shikojmë dialogun e Brukselit",



ka thënë Raqi. Lista Serbe, që është partia udhëheqëse e serbëve në Kosovë dhe ka mbështetjen e Beogradit zyrtar, ka thënë se e mbështet plotësisht presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për takimin që ai do të mbajë në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, më 18 gusht.

Raqi ka thënë se Kosova mund "me forcë të përpiqet të zbatojë disa vendime", por se "ne nuk do të marrim pjesë në të". Raqi, që është edhe ministër për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, tha se pret që presidenti serb Vuçiq të gjejë një mënyrë për ta "tejkalluar këtë krizë" në dialogun në Bruksel. Më 31 korrik dhe 1 gusht serbët

lokalë bllokuan rrugët që çojnë në dy pikëkalimet kufitare - Jarinjë dhe Bërnjak - që lidhin Kosovën dhe Serbinë. Bllokadat u ngritën për t'i kundërshtuar dy vendimet e Qeverisë së Kosovës. Vendimi i parë ka të bëjë me targa serbe me akronime të qyteteve të Kosovës. Kosova dëshiron që rreth 10 000 makina me targa sikurse KM, PZ, UR e të ngjashme të reregjistrohen në targa RKS (Republika e Kosovës), pasi vlerëson se targa të tilla që qarkullojnë në veriun e banuar me shumicë serbe janë të jashtëligjshme. Vendimi i dytë i Qeverisë së Kosovës është për lëshimin e një dokumenti për hyrje-dalje, për të gjithë shtetasit e Serbisë që hyjnë në Kosovë. Ky dokument jepet falas dhe ka vlefshmëri prej 90 ditësh. Me dokument të tillë, qytetarët e Kosovës janë pajisur nga autoritetet serbe që 11 vjet dhe palët ishin marrë vesh për një gjë të tillë me nënshkrimin e Marrëveshjes për lirinë e lëvizjes më 2011. Pasi serbët hoqën barrikatad pasditen e 1 gushtit, Qeveria e Kosovës njoftoi se do ta shtyjë zbatimin e vendimeve deri më 1 shtator./REL



PRESIDENTI I SHQIPËRISË PËRFUNDON VIZITËN DYDITORE NË KOSOVË

Opozita në Kosovë i ofron bashkëpunim presidentit të Shqipërisë

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, me vizitën në kompleksin e Lidhjes së Prizrenit, ka përmbyllur qëndrimin dyditor në Kosovë. Me këtë rast, Begaj ka thënë se shpreson që ngjarja e Lidhjes së Prizrenit t'i bëjë të dyja anët e kufirit të mendojnë për vizionin dhe aspiratat që kanë pasur udhëheqësit e asaj kohe dhe t'i kthejnë në realitet në ditët e sotme. Para se ta përmbyllte vizitën e tij të parë zyrtare në Kosovë, Begaj është takuar me kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi dhe atë të AAK-së, Ramush Haradinaj, por jo edhe me atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku. Krasniqi dhe Haradinaj i kanë ofruar mbështetjen e plotë Begajt për avancimin e marrëdhënieve vëllazërore në mes të dy vendeve

Partisë Demokratike të Kosovës në ruajtjen dhe avancimin e marrëdhënieve vëllazërore në mes të Shqipërisë dhe Kosovës", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Më tutje, Krasniqi ka bërë me dije se e ka falënderuar Begajn dhe Shqipërinë për hartimin e Rezolutës dhe për dërgimin e saj në Asamblenë e Këshillit të Evropës që ka për synim vërtetësinë e luftës së pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). "Po në këtë takim presidentin e urova edhe për

hapjen zyrtare të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, e cila është jo vetëm arritje e madhe për shtetin shqiptar, por edhe një hap i rëndësishëm për tërë rajonin në avancimin e kërkesave dhe të drejtave tona. Presidentin Begaj e falënderova për angazhimin dhe kontributin e shtetit shqiptar për hartimin e Rezolutës dhe dërgimin e saj në Asamblenë e Këshillit të Evropës që ka për synim vërtetësinë e luftës së pastër të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës", ka shkruar Krasniqi. Ndërsa kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, pas takimit me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, ka mbajtur një konferencë për medie. Në këtë konferencë, Haradinaj ka thënë se AAK-ja është interesuar t'i thellojë marrëdhëniet në mes të dy shteteve. I pari i AAK-së ka treguar se me Begajn ka biseduar për mundësinë e dhënies së shtetësisë çdo shqiptari, sigurinë, infrastrukturën, energjinë etj. "Jemi të interesuar që ta

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 16 GUSHT - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Kosovë, është takuar me kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi dhe me liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj, ndërsa nuk është takuar me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku. Pas takimit me Begajn, Krasniqi ka thënë se ka qenë i nderuar që e

ka takuar presidentin shqiptar. Më tutje, Krasniqi ka thënë se i ka ofruar mbështetjen e plotë të PDK-së për avancimin e marrëdhënieve vëllazërore. "Kënaqësi e veçantë ta takoj presidentin e sapozgjedhur të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, në kuadër të vizitës së tij të parë zyrtare në Republikën e Kosovës, të cilin e urova për detyrën e re dhe i ofrova mbështetjen dhe bashkëpunimin e plotë të



Miratohet kërkesa e avokatëve të liderëve të UÇK-së për përgjigje të përbashkët ndaj ZPS-së

HAGË, 16 GUSHT - Gjykatësi i procedurës paraprake në Gjykatën Speciale, Nicolas Guillou, ka aprovuar kërkesën e ekipeve të mbrojtjes në rastin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, për zgjatje të kufirit të fjalës për përgjigje të përbashkët ndaj përgjigjes së Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) për mocionin e përbashkët të mbrojtjes për zbulim në bazë të rregullës 103. Në vendim është thënë se gjyqtari i procedurës paraprake ka konstatuar se kërkesa është dorëzuar mjaftueshëm përpara afatit që mbrojtja t'i dorëzojë përgjigjet e saj, siç kërkohet nga neni 36 (1) i udhëzimit praktik.

"Gjyqtari i procedurës paraprake merr parasysh argumentet e mbrojtjes që kanë të bëjnë me (i) rëndësinë e detyrimeve për zbulim sipas rregullave 103 të Rregullores dhe çështjes së veçantë në fjalë; dhe (ii) argumentet e shumta të paraqitura në kërkesën e rregullit 103 të përbashkët të mbrojtjes. Për më tepër, duke pasur parasysh se ndryshimi i kërkuar është mjaft i kufizuar dhe do të mundësojë paraqitjen e një përgjigjeje të përbashkët, gjyqtari i procedurës paraprake konstaton se nuk do të ketë

asnjë paragjykim nga ZPS për dhënien e zgjatjes", është thënë në vendimin e gjyqtarit Guillou. Sipas vendimit, gjyqtari i procedurës paraprake ka konstatuar se është vërtetuar shkaku i mirë që garanton zgjatjen e kërkuar të kufirit të fjalës dhe e zgjeron kufirin e fjalës për përgjigjen e përbashkët të mbrojtjes deri në 500 fjalë.

Ndryshe, më 29 prill, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit. Prokuroria po pretendon se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë e Semetishtë. Në aneksin e publikuar sa iu përket krimeve që pretendohen se ndodhën në Semetishtë dhe Budakovë, prokuroria ka listuar krimet e luftës si arrestimi dhe ndalimi i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor ose çnjerëzor, torturë, vrasje. Ndërkaq, si krime kundër njerëzimit i ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen, zhdukjen e personave me forcë dhe persekutimin. Kurse për krimet që pretendon që ndodhën në Gjilan, si krime lufte i ka listuar arrestimin dhe ndalimin e



paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor ose çnjerëzor, torturën dhe vrasjen. Ndërsa si krime kundër njerëzimit ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen dhe persekutimin.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Selimi më 11 nëntor. Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020. Sipas akuzës, së paku midis marsit 1998 deri në

shtator 1999, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët kishin qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë. "Ndër këta kundërshtarë përfshiheshin persona që ishin, ose që konsideroheshin se kishin qenë: (a) bashkëpunëtorë ose të lidhur me forca, zyrtarë ose institucione shtetërore të RFJ-së, ose që (b) ndryshe nuk

mbështetnin qëllimet ose metodat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së, ndër të cilët persona të lidhur me LDK-në dhe serbë, romë dhe persona të kombësive të tjera (bashkërisht, 'kundërshtarët'). Ky qëllim i përbashkët përfshinte krimet e përndjekjes, burgosjes, arrestimit dhe ndalimit arbitrar ose të paligjshëm, akte të tjera çnjerëzore, trajtimin mizor, torturën, vrasjen dhe zhdukjen me forcë të personave", është thënë në aktakuzë.

Ndaj këtyre akuzave, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë shpallur të pafajshëm. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

thellojmë bashkëpunimin me Shqipërinë. Kemi veçuar disa tema të rëndësishme. Kemi filluar me çështjen e shtetësisë për të gjithë shqiptarët. Iniciativa ime ka qenë me vite për një pakt të paqes. Kemi diskutuar për çështjen e hekurudhës, kemi folur për bashkëpunimin për energji. Është çudi që mos të bashkëinvestojmë në energji. Kemi folur edhe për marrëveshjen Kosovë - Serbi, për njohje reciproke e jo për arritje që na kthejnë mbrapa", ka thënë Haradinaj.

Ndërsa zyrtarët e LDK-së kanë shprehur keqardhje për mosrealizimin e takimit të Abdixhikut me Begajn.

Begaj: Lidhja e Prizrenit ka simbolikë të jashtëzakonshme për shqiptarët

Pas takimit me Krasniqin dhe Haradinajn, Begaj ka vizituar Kompleksin e Lidhjes së Prizrenit, duke përmblytur qëndrimin e tij në Kosovë. Ai në Prizren ka thënë se shpreson që ngjarja e Lidhjes së Prizrenit t'i bëjë të dyja anët e kufirit të mendojnë për vizionin dhe aspiratat që kanë pasur udhëheqësit e asaj kohe dhe t'i kthejnë në realitet në ditët e

sotme.

Begaj pas homazheve në Kompleksin e Lidhjes së Prizrenit ka thënë se kjo vizitë ka një simbolikë të jashtëzakonshme. "Është kënaqësi e madhe që të jem në Prizren, në qytetin e mrekullueshëm, të një prej ngjarjeve më të rëndësishme të popullit shqiptar, të Lidhjes së Prizrenit. Ardhja këtu ka një simbolikë të jashtëzakonshme sepse qyteti përfaqëson vlerat e qëndrësës, të bashkimit dhe bashkëpunimit. Kështu shpresoj që kjo ngjarje t'i bëjë të dyja anët e kufirit të mendojnë për vizionin dhe aspiratat që kanë pasur në atë kohë udhëheqësit e asaj kohe dhe t'i bëjmë realitet në ditën që ne po jetojmë", ka thënë Begaj.

Ndërsa kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka treguar për temat që kanë folur me presidentin shqiptar. Sipas tij, bashkëpunimi dhe mundësia e bashkimit të vlerave ishin çështjet kryesore për të cilat kanë biseduar. "Është privilegj që presidenti i Shqipërisë po na viziton. Jorastësisht ka ardhur në komunën e Prizrenit për shkak të peshës specifike, për shkak të traditës dhe për shkak të rëndësisë që ka për historinë kombëtare për trashëgiminë tonë që e kemi dhe



perspektivën. Biseduam për një të ardhme më të mirë për bashkëpunim dhe bashkim të shumë gjërave dhe shumë vlerave që neve na bashkojnë dhe jam i sigurt se në këtë drejtim do të lëvizim dhe do të jemi të suksesshëm", ka thënë Totaj.

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, një ditë më parë është takuar me presidenten Vjosa Osmani, kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti. Po

ashtu, ai ka bërë homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe kompleksi memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Ai të hënën në një konferencë të përbashkët me Osmanin ka thënë se shteti shqiptar mbështet anëtarësimin e Kosovës në BE dhe NATO. Ai ka thënë se Shqipëria do të jetë zëdhënëse e Kosovës në OKB. "Shqipëria mbështet fuqimisht anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe vlerëson se NATO-ja

mbetet garantuese e paqes në rajon dhe aleate strategjike e Kosovës dhe Shqipërisë", ka thënë Begaj në një konferencë për medie mbajtur me presidentin Osmani në Prishtinë. Po ashtu, Begaj ka kërkuar nga BE-ja që ta mbajë premtimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Begaj në ditën e parë të vizitës zyrtare në Kosovë ka folur edhe për UÇK-në. Ai ka thënë se nuk ka raport që mund ta njolloset luftën dhe luftëtarët e UÇK-së.

Osmani ia dha urdhrin "Hero i Kosovës" afamiljes së heroit Sali Çekaj

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ia ka dorëzuar urdhrin "Hero i Kosovës" familjes së heroit të kombit, Sali Çekaj, të cilin ia kishte ndarë presidenti historik i Kosovës, Ibrahim Rugova, në vitin 2005.

Në një ceremoni me familjarë të heroit Sali Çekaj, presidentja Osmani ka theksuar se kontributi i tij ishte i jashtëzakonshëm dhe shtrihej në shumë kohë e drejtime.

"Një jetë e tërë në shërbim të kombit dhe atdheut. Sali Çekaj e gjejmë në ballë të betejave për organizimin e jetës institucionale dhe rezistencës ndaj pushtimit të Kosovës gjatë fillimit të viteve të '90-ta. Pas largimit nga

Kosova, për t'i shpëtuar arrestimit nga regjimi pushtues i Serbisë, Sali Çekaj dha kontribut të pasqorë në organizimin e diasporës shqiptare dhe në sensibilizimin e çështjes së Kosovës në Evropën Perëndimore", ka theksuar Osmani.

Sipas saj, ai ka pasur rol qendror në organizimin e rezistencës së armatosur për liri dhe pavarësi të Kosovës, që në fillim e para të organizimit institucional të formacioneve të armatosura të Republikës së Kosovës dhe në organizimin dhe shtrirjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Sali Çekaj ka organizuar dhe drejtuar me shkathësi dhe trimëri disa nga betejat më të



lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në rënien e tij heroike në betejën e

Koshares", ka thënë Osmani. Ndërsa familjarë të heroit Sali Çekaj falënderuan presidenten

Osmani për respektin jo vetëm ndaj heroit, por edhe të luftës çlirimtare.

Aktakuzë për mashtrim kundër dhjetë personave



PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PRSK) ka ngritur aktakuzë kundër dhjetë personave të dyshuar për mashtrimin nga Gjermania të disa shtetasve të Kosovës, ka njoftuar sot prokuroria. Dhjetë të akuzuarit, me iniciale A. K., F. G., K. B., H. K., E. Z., A. S., Q. K., H. B., L. B dhe L.B., dyshohen se nga Gjermania kishin mashtruar financiarisht disa shtetas të Kosovës, kryesisht të moshave të shtyra, duke u prezantuar rrejshëm dhe duke iu thënë se kanë fituar shuma të majme në lotari. "[...] Ashtu që i kanë nxitur që të dërgojnë të holla përmes

bashkëpunëtorëve të tyre në Gjermani apo përmes unioneve financiare si: Moneygram, Western Union, Capital-Ria, Vllesa-Ria, në emra të ndryshëm në Kosovë, apo të blejnë kuponët e Amazon-it dhe t'u tregojnë kodet e tyre të cilët pastaj të pandehurit i kanë shfrytëzuar për blerje personale online, kështu që të pandehurit A. K., K. B., E. Z., A. S., F. G., H. K., Q. K dhe H. B., në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale 'Mashtrimi në vazhdim', është thënë në njoftimin e Prokurorisë Speciale.

Po ashtu, një nga pjesëtarët e grupit të të akuzuarve, L. B., dyshohet se kishte vazhduar

t'i mashtronte financiarisht disa shtetas në Kosovë, ndaras nga grupi i nëntë të tjerëve. "Ndërkaq, i pandehuri L. B. për një kohë të pavërtetuar ka marrë pjesë në veprimtaritë kundërligjore të përshkuara në diapozitivin e parë me të pandehurin A. K. gjatë vitit 2018/2019, ka filluar të punojë ndaras, në atë mënyrë që me të pandehurin L. B. i kanë kontaktuar viktimat në Gjermani përmes telefonit, e pastaj me ndihmën e bashkëpunëtorëve të tyre C. B., F. H., A. D. si dhe me persona të tjerë të paidentifikuar kanë marrë të holla prej viktimave, si E.B.F", ka njoftuar PRSK-ja.

KMDLNj: Moslejimi i shamisë në shkolla nuk paraqet shkelje të të drejtave të njeriut

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar lidhur me debatin e ditëve të fundit për udhëzimin administrativ që lejon bartjen e shamisë në shkolla.

Ky këshill ka thënë se janë paraqitur disa raste kur femrat me mbulesë ishin diskriminuar në vendet e punës, apo edhe kur disa nxënës të shkollave fillore ishin larguar nga procesi mësimor.

Mirëpo, KMDLNj-ja konsideron se bullizimi apo stigmatizimi është shkelje e të drejtave të njeriut, ndërkaq sa i përket moslejimit të mbulesës, KMDLNj-ja konsideron se kjo është e rregulluar me ligj dhe se nuk paraqet shkelje të të drejtave të njeriut. "Ky Udhëzim Administrativ është ende në

fuqi në Kosovë, është i zbatueshëm dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Si i tillë nuk mund të kundërshtohet, përjashtuar rastin kur eventualisht do të shfuqizohej e për të cilin është i domosdoshëm ndryshimi i Kushtetutës aktuale e që, së paku, deri më tani nuk është ndonjë nismë e tillë", është thënë në komunikatë.

Më tutje, KMDLNj-ja ka thënë se premtimet e subjekteve politike gjatë fushatave nuk kanë qenë të duhura dhe vetëm kanë nxitur debate të panevojshme.

"Bartja apo mosbartja e shamisë për nxënës në moshën 18 vjeçe është shndërruar thuaja tërësisht në fushatë politike dhe po bëhet për qëllime politike. Jo pse mungon e drejta për ushtrim të drejtave dhe të



lirive fetare. Në këtë kontekst është i papranueshëm dhe i dënueshëm linçimi publik i të gjithë atyre që janë kundër përdorimit të shamisë për nxënës e moshës jomadhore dhe që kërkojnë të zbatohet Udhëzimi

Administrativ në fuqi dhe të respektohet Kushtetuta e Kosovës. Edhe ky linçim po bëhet në formë të fushatës", është thënë në këtë komunikatë.

KMDLNj-ja, ndër të tjera, ka konstatuar se çdo imponim

apo keqpërdorim i autoritetit të prindit ose kujdestarit që e detyron një femër të moshës jomadhore, nën moshën 18 vjeçe të bartë shami paraqet shkelje flagrante të drejtave të njeriut dhe, si e tillë, duhet të dënohet nga institucionet përkatëse.

"Mbështetur në ligjet në fuqi, ku qartazi janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet, KMDLNj-ja propozon një prerje të qartë midis institucioneve arsimore publike dhe atyre fetare. Në institucionet arsimore publike si shenjë identifikuese duhet të jetë një uniformë unike, pa lejuar asnjë simbol apo veshje fetare, pa asnjë përjashtim në mënyrë që të mos lejohet asnjë diskriminim apo supremacion i një besimi, pavarësisht numrit të praktikuesve", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

Prapë shkurtime të energjisë elektrike në Kosovë

PRISHTINË, 16 GUSHT - Qytetarët e Kosovës prapë do të përballen me shkurtime të energjisë elektrike, ka njoftuar Viktor Buzhala, zëdhënës në Kompaninë për Distribimin e Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS). Ai për REL-in nuk ka dhënë hollësi për orarin e kufizimeve.

Edhe KEDS-i ka dërguar mesazhe në telefonat mobilë të konsumatorëve për orarin e ndërprerjes së rrymës, që kryesisht zgjasin dy orë.


Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është përgjegjëse për prodhimin e energjisë elektrike, kurse për furnizim është Kompania për Distribimin e Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS).

Në orët e vonë të së dielës KEDS-i ka njoftuar se

qytetarët e Kosovës do të përballen me shkurtime nga 15 gushti por, pa u bërë 24 orë nga ky njoftim, Ministria e Ekonomisë konfirmoi se është rikthyer furnizimi i rregullt me energji elektrike, pas një marrëveshjeje të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

KEDS-i e ka arsyetuar këtë vendim me çmimet e larta për blerje të rrymës në tregjet ndërkombëtare.

Sipas Ministrisë së Ekonomisë, prodhimi ditor i rrymës në KEK aktualisht është 507 megavat në orë, kurse kërkesa për konsum është deri në 750 megavat në orë. Diferenca tjetër duhet të importohet. Çmimi i energjisë në bursën hungareze (HUPX) është rreth 430 euro për megavat. Një megavat energji



në gusht të vitit të kaluar ka kushtuar deri në 150 euro. Në Kosovë, rreth 94 për qind e

energjisë prodhohet nga djegia e thëngjillit, ndërsa rreth 6 nga burimet e

ripërtërishme sikurse hidrocentralet, centralet me erë dhe panelet diellore.

Familjet shqiptare e kanë të pamundur blerjen e një shtëpie



TIRANË, 16 GUSHT - Familjet shqiptare po e kanë çdo ditë edhe më tepër të vështirë blerjen e një apartamenti. Me rritjen e çmimeve prej luftës në Ukrainë, sidomos prej kërkesës në rritje prej sasisë së madhe të parave që po pastrohen në vend gjatë viteve të fundit, çmimet për një metër katror apartamenti në Tiranë kanë shkuar në nivele të paperceptueshme.

Referuar radhitjes që ka bërë “Numbeo”, një ndër platformat më të mëdha botërore për

përpunimin e të dhënave, Shqipëria renditet në 30 vendet e fundit sa i përket mundësisë së blerjes së një apartamenti sipas të ardhurave mujore që kanë familjet.

Vendi renditet në pozicionin e 30 me një indeks 15.80, ndërkohë që shumë më mirë është se të gjitha vendet e rajonit si Kosova, Serbia, Greqia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnja me një indeks shumë më të ulët se ne. Situata duket se është përkeqësuar edhe më tepër

gjatë gjysmës së parë të këtij viti pasi më herët vendi renditej në pozicionin e 39 duke lënë pas Serbinë.

Çfarë mat indeksi “Raporti mes çmimit dhe të ardhurave”?

Raporti i çmimit ndaj të ardhurave është indeksi bazë për përbalueshmërinë e blerjes së apartamenteve (më e ulët është më mirë). Përgjithësisht llogaritet si raporti i çmimeve mesatare të apartamenteve ndaj të ardhurave mesatare të disponueshme familjare.

Fillon ekzekutimi i pagesave të subvencioneve për çdo kulturë bujqësore

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka bërë me dije se ka filluar ekzekutimi i pagesave për përfituesit e subvencioneve në kuadër të Programit për Pagesa Direkte 2022 për çdo kulturë bujqësore. “Vlera e proceduar, sipas Pecit, është mbi 5 milionë euro. Ka filluar procedimi i pagesave për përfituesit e subvencioneve në kuadër të Programit për Pagesa Direkte

2022 për çdo kulturë bujqësore. Vlera e proceduar për pagesë është 5.161.966.81 euro, ndërsa numri i bujqve që do t'i përfitojnë këto mjete deri më tani është 3901. Duke qenë se afati për sasinë e dorëzuar të grurit është data 2 shtator, edhe pagesën për sasinë e dorëzuar të grurit në vlerë prej 0.03 euro/kg, MBPZHR - AZhB do ta bëjë pas kësaj date si pagesë e veçantë për të gjithë

aplikuesit e grurit që dëshmojnë sasinë e dorëzuar të grurit duke u bazuar në kriteret e parapara me Programin e Pagesave Direkte 2022, konkretisht Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2022. Dëshmia për sasinë e dorëzuar të grurit dorëzohet në drejtoritë komunale për bujqësi në komunat përkatëse deri më 2 shtator 2022 në ora 16:00”, ka njoftuar Peci.



Inflacioni në ShBA arrin në 9.1 për qind, më i larti në 40 vjetët e fundit

UASHINGTON, 16 GUSHT - Rritja më e madhe e inflacionit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në 40 vjetët e fundit po e godet rëndë vendin. Në Nju-Jork, një metropol me gati


9 milionë banorë, është gjithnjë e më e vështirë të paguash qiranë dhe ushqimin. Në maj të këtij viti çmimet e ushqimeve në Nju-Jork u rritën me ritmin më të shpejtë që nga

viti 1981. Kjo rritje u ngadalësua pak në qershor, por çmimet e ushqimeve në ShBA janë ende 9.1 për qind më të larta se një vit më parë.

Kjo është rritja më e madhe që

nga viti 1981. Inflacioni i lartë është pasojë e ndërprerjeve në zinxhirët e furnizimit dhe të biznesit të shkaktuar nga vendosja e masave kundër pandemisë.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Orari i garave dhe çmimi i biletave për Lojërat Olimpike 'Paris 2024'



PARIS, 16 GUSHT - Komiteti Olimpik Ndërkombëtar ka publikuar orarin e garave si dhe çmimin e biletave për Lojërat Olimpike "Paris 2024". LO Paris 2024 do të mbahet prej 26 korrik deri më 11 gusht të vitit 2024 në kryeqytetin e Francës. Për shkak të orarit të ngjeshur garat në disa sporte do të nisin më 24 korrik, kurse medaljet e para do të ndahen më 27 korrik, kur do të zhvillohen sportet si: xhudo, çiklizmi, skerma, zhytja, ragbi, shigjetaria, noti dhe skejtboarding. Ceremonia hapëse do të zhvillohet në mbrëmjen e 26 korrikut. Në total do të jenë

329 gara, të cilat zhvillohen brenda 19 ditëve. Finalet e notit dhe atletikës do të zhvillohen në mbrëmje. Sporti i Kosovës më i suksesshëm, xhudo, që ka edhe tri kampione olimpike, do t'i zhvillojë garat prej 27 korrikut deri më 3 gusht 2024. Edhe në dy Lojërat e fundit Olimpike, ku është përfaqësuar Kosova, xhudo ka qenë një nga sportet e para që ka nisur garat. Dallimi me "Rio 2016" dhe "Tokio 2020", është se luftërat për medalje do të zhvillohen prej orës 16-19:00 me kohën tonë lokale. IOC ka publikuar edhe detaje për biletat, të cilat do të dalin në shitje prej

dhjetorit të këtij viti. Gjithsej 10 milionë bileta do të jenë në shitje për Lojërat Olimpike, kurse 3 milionë për Lojërat Paralimpike. Çmimi më i lirë i tyre, rreth 1 milion sish, do të jetë 24 euro. Gjysma e biletave do të kushtojnë 50 euro ose më pak, ndërsa të tjerat rreth 100, 200 dhe 300 euro. Për garat e xhudos, një biletë do të kushtojë prej 90 – 330 eurosh. Për KOK-un, LO Paris 2024 do të jenë të tretat pas debutimit të artë në "Rio 2016" me medaljen e artë të Majlinda Kelmendit, të cilën e pasuan Distria Krasniqi e Nora Gjakova me medaljet e arta të fituara në "Tokio 2020".

SHKURT

KB Prishtina përforcohet me Dustin Thomas

Klubi i Basketbollit Prishtina vazhdon të bëjë përf forcime të mëdha para fillimit të sezonit të ri. Kryeqytetasit e Kosovës kanë njoftuar të martën se i kanë siguruar shërbimet e basketbollistit amerikan Dustin Thomas. Ai luan në pozitën e alo-qendrës, ndërsa sezonin e kaluar ishte zgjedhur "MVP" i Ligës Ballkanike. Prishtinasit i kanë uruar mirëseardhje basketbollistit, nga i cili presin shumë në edicionin që vjen. Kryeqytetasit synojnë të rikthehen në majat e futbollit të Kosovës dhe të kenë paraqitje të suksesshme edhe në garat evropiane.

KF Besa në krizë të thellë, rrezikon shuarjen

Klubi i njohur nga Kosova, Besa nga Peja po kalon çastet më të vështira në histori të klubit. Pasi nuk arritën të mbijetojnë në Ligën e Parë gjatë sezonit të kaluar, pejanët duket se nuk do t'i fillojnë garat as në Ligën e Dytë. "Indeksonline" mëson se KF Besa nuk është e gatshme të garojë në Ligën e Dytë pas problemeve financiare dhe atyre organizative. Skuadra e njohur nga Kosova do të tërhiqet nga garat derisa të riorganizohet për të filluar nga zero. Vendin e saj në Ligën e Dytë do ta zë një skuadër nga Liga e Tretë. Besa ka fituar tri herë Superligën e Kosovës derisa tri herë të tjera është shpallur kampione e Kupës së Kosovës.

Januzaj dikur refuzonte Shqipërinë e Kosovën, tash mund të përfundojë në Serinë B

Adnan Januzaj dikur pati refuzuar Kombëtaren e Shqipërisë dhe Përfaqësuesen e Kosovës, por sot të gjithë e kanë harruar. Sulmuesi është pa skuadër momentalisht, pasi i ka skaduar kontrata me baskët e Real Sociedadit këtë verë dhe spanjollët nuk i ofruan rinovim, duke e nxjerrë në mes të "katër rrugëve". Pas pesë sezonesh në Spanjë, lojtari ka mbetur pa skuadër dhe pse është lojtar i lirë dhe kjo ka të bëjë me kërkesat e ekzagjeruar që ai kërkon. Në fillim të merkatos ka pasur interesim nga disa klube në La Liga dhe jo vetëm, por tani i vetmi opSION real është Genoa, në Serinë B, në Itali. Klubi italian i ka vendosur në "tavolinë" ofertën Januzajt i cili nuk ka shumë kohë në dispozicion për t'u menduar dhe drejtuesit e Genoas kanë ofruar shumë herë më pak sesa lojtari kërkonte në fillim të merkatos. Me një CV të pasur në emra, si Manchester United, Dortmund, Sunderland dhe Real Sociedad, karriera e Adnan Januzajt duhej të ishte shumë herë më ndryshe sesa realiteti e paraqet atë, pasi tani karriera e Januzajt është në rënie të lirë.

Pensionohet gjyqtari Besfort Kasumi

PRISHTINË, 16 GUSHT - Pas karrierës më shumë se 10-veçare, një prej gjyqtarëve më të mirë të futbollit në Kosovë, Besfort Kasumi, është pensionuar. Kasumi, i shpallur një herë Gjyqtari i Vitit në futbollin e Kosovës, me qindra

ndeshje të gjykuara në futbollin vendor si dhe mbajtës i stemës së FIFA-s që pesë vjet, ka vendosur të largohet nga zeja e gjyqtarit këtë vit. Ai nuk do të gjykojë me ndeshje të futbollit në Kosovë. "Paparaci" mëson se

Kasumi ka vendosur të pensionohet nga profesioni i gjyqtarit, mirëpo ai do të mbetet pjesë e futbollit, përkatësisht Federatës së Futbollit të Kosovës. Kasumi ishte një ndër gjyqtarët më cilësor në elitën e futbollit të

Kosovës, ndërsa ishte shpallur gjyqtari më i mirë për vitin 2015. Përpos Superligës së Kosovës, Kasumi ishte certifikuar edhe me stemën e FIFA-s, me ç'rast arriti të gjykonte dhjetëra ndeshje të nivelit ndërkombëtar.



Shtatë klubet e mëdha evropiane që refuzuan Ronaldon

MANCHESTER, 16 GUSHT - Cristiano Ronaldo është në momentin më të vështirë të karrierës së tij, pasi për herë të parë nuk po gjen atë që kërkon. Portugezi është duke kaluar një moment krize te Manchester Unitedi

për shkak se ai kërkoi largimin gjatë merkatos së verës, por deri më tani nuk është bërë e mundur për disa arsye. Në momentin e parë ishte Unitedi që vuri veton për të mos e lënë sulmuesin të largohet, por

me kalimin e ditëve u vu re se skuadrat që portugezi pretendonte të transferohej nuk ishin të interesuara për shërbimet e tij. Milani, Interi, Bayerni, Chelsea, Real Madridi, PSG-ja dhe Atletico Madridi i kanë

thënë "jo" afrimit të tij. Me nisjen e sezonit, situata te "Djajtë e Kuq" u përkeqësua më tepër, aq sa tani duket se Ten Hag ka ndryshuar qëndrim sa i përket të ardhmes së legjendës portugeze.



Në mes të pushtimit rus, Vitali Klitschko divorcohet nga gruaja

Kiev, 16 gusht - LEGJENDA E BOKSIT E PËSHAVE të rënda, Vitali Klitschko, është ndarë nga gruaja Natalia, pas 26 vjetësh martesë. Sidoqoftë, 51-vjeçari ukrainas ka këmbëngulur se kanë ende "marrëdhënie shumë të mirë". Klitschko është kryebashkiak i kryeqytetit ukrainas Kiev. Ish-modelja dhe muzikantja Natalia, 48 vjeçe, jeton prej vitesh në Gjermani. Dyshja u martuan në vitin 1996, pas takimit të parë të raportuar në kryeqytetin ukrainas. Klitschko ka konfirmuar se të dy kanë bërë tashmë zyrtarisht kërkesën për divorc. Ai tha për gazetën gjermane "Bild": "Kemi bërë kërkesë për divorc së bashku, sepse kemi vite që jetojmë të ndarë dhe tani duam ta zyrtarizojmë. Ne kemi një marrëdhënie shumë të mirë dhe e respektojmë njëri-tjetrin, por prej kohësh jetojmë të ndarë, në qytete të ndryshme". Ish-çifti ka tre fëmijë së bashku; 22, 19 dhe 16 vjeç. Natalia është gjysmëgjermane, gjysmë, punon si mësuese e jogas. Vitali ende thuhet se i shkruan asaj çdo mëngjes për t'i thënë se është i



sigurt në Kiev. Natalia pretendohet se ka ndihmuar në kujdesin e refugjatëve që kanë ikur nga Ukraina e shkatërruar nga lufta në gjashtë muajt e fundit. Si boksier, Vitali mburrej me një rekord 45-2, duke fituar titujt e peshave të rënda WBO dhe WBC gjatë rrugës. Ai u përfshi në politikë përpara se të tërhiqej nga sporti dhe mban postin e

kryebashkiakut të Kievit që nga viti 2014. Krahas vëllait dhe ikonës së boksit, Wladimir, Vitali u zotua se ishte i gatshëm të vdiste për vendin e tij, duke luftuar kundër pushtuesve rusë. Dy vëllezërit rrokën armët për ta mbrojtur Kievin nga ushtarët rusë, kur pushtimi kishte në shënjestër kryeqytetin ukrainas në fillim të këtij viti.

Verstappeni: Jemi ende në ndjekje të Ferrarit, është më i shpejtë se ne

SPIELBERG, 16 GUSHT - Edhe pse Red Bulli e Max Verstappeni kryesojnë renditjet e këtij botërori në Formula 1, ato për skuadra dhe pilotë, sërish piloti holandez nuk ndihet i sigurt për titullin kampion. Ai ka 80 pikë avantazh ndaj Charles Leclerc me Ferrarin, ndaj kërkon një pjesë të dytë të kampionatit më të mirë. "Ju më njihni, nuk jam nga ata që gjatë pushimeve ulem në plazh për të marrë reze dielli", ka thënë piloti holandez i Red Bullit. Këtë sezon, ai ka fituar 8 nga 13 garat, por shpesh ka përfutur nga gabimet e makinës italiane apo pilotëve të saj, që në disa gara i kanë dhuruar fitoren. "Nuk më intereson diferenca që kemi në renditje. Ajo që më intereson është të jemi të



përkryer në çdo fundjavë. Ju e keni parë që Ferrari ka qenë më i shpejtë se ne thujse çdo të shtunë, ndaj janë përpara nesh.

Jemi ne ata që ndjekim Ferrarin thujse në çdo garë dhe më pas i mundim, ndaj duhet kujdes", ka shtuar holandezi.

Bayerni, gati t'i mbushë arkat nga sponsori kryesor

Bayern Munchen ka bërë me dije se ka arritur një marrëveshje të re me sponsorin e saj kryesor "Deutsche Telekom" deri në vitin 2027. Sipas medieve gjermane, në bazë të

marrëveshjes së re, "Deutsche Telekom" do t'u paguajë plot 50 milionë euro në sezon gjigantëve të Munchenit. Mediet gjermane kanë bërë me dije se në bazë të kësaj marrëveshjeje të

re, Bayerni do të përfitojë 5 milionë euro më shumë në sezon. "Deutsche Telekom" është një partner afatgjatë me Bayern Munchenin, teksa marrëveshja e parë daton që në

vitin 2002 dhe marrëveshja mes palëve është rinovuar tri herë gjatë kësaj periudhe. Përtej milionave të siguruar nga kjo kompani, përfitime pritet të kenë edhe tifozët "bavarezë".

Nga vetë kompania e telekomunikacionit bëjnë me dije se përvoja 20-vjeçare e bashkëpunimit mes tyre dhe Bayernit ka qenë vendimtare për rinovimin e marrëveshjes.

SHKURT

Barça kërkon 25 milionë euro për Aubameyangun

Barcelona duket se ka ndryshuar mendje sa i përket qëndrimit për sulmuesin Pierre-Emerick Aubameyang, i cili është cilësuar i pashitshëm pak ditë parë. Chelsea bëri ofertën e parë të kontratës për shërbimet e gabonezit, por "blaugranat" e refuzuan kategorikisht. Tashmë, sipas shtypit britanik, Barça mund ta lejë të lirë sulmuesin e saj për një shifër prej 25 milionë eurosh. "Daily Mail" thekson se Chelsea është ende e interesuar, por nuk ka ndër mend të paguajë atë shifër dhe se përpiqet ta përfshijë në operacion Marcos Alonson.

Spalleti, pas fitores 2-5: Isha i sigurt se do të bëjmë paraqitje të madhe

Napoli shkëlqeu në ndeshjen e javës së parë të kampionatit. Napoletanën bindën me lojë dhe mundën 2-5 Veronën në Bentegodi. Pas fitores, Luciano Spalleti ka thënë se ishte i sigurt që futbollistët do të tregonin një lojë të madhe për faktin se e kanë dëshmuar gjatë gjithë javës. "Nuk është një ndeshje që mund të tregojë se kush do të jetë rrugëtimi ynë. Në disa momente, në disa pjesë të lojës kemi treguar se jemi të rinj, edhe pse kemi fituar në mënyrë të qartë. Por në disa zgjedhje, në disa vendosje në fushë, kemi lejuar shumë hapësirë. Duhet t'i vlerësojmë menjëherë kualitetet superiore që kemi. Isha i sigurt që Napoli do të bënte një paraqitje të madhe sepse e kisha parë dëshirën e lojtarëve gjatë javës. Duhet vetëm ta ngrehim ritmin në disa çaste dhe t'i bëjmë keq kundërshtarit", ka thënë Spalleti.

Sergio Gomez paraqitet te City

Manchester City ka njoftuar për marrëveshjen me Anderlechtin për Sergio Gomezin, i cili ka nënshkruar për katër vjet. 21-vjeçari spanjoll bashkohet nga Anderlecht, me mbrojtësin e majtë që ka bërë 49 paraqitje për klubin belg gjatë sezonit 2021-2022. Sergio e filloi karrierën te të rinjtë e Barcelonës përpara se të largohej nga klubi katalanas për t'u bashkuar me skuadrën e Bundesligës, Borussia Dortmund, në fillim të vitit 2018. Ai më pas kaloi dy sezone përsëri në Spanjë në huazim te Huesca duke e ndihmuar klubin ta fitonte promovimin në La Liga në fund të sezonit 2019/20 përpara se të bashkohej me Anderlechtin në verën e 2021-s. Gomezi kishte një sezon të shkëlqyer individual nën drejtimin e ish-trajnerit të Anderlecht, Vincent Kompany.

Unitedi shpreh interesim për Casemiro

Manchester Unitedi është i interesuar për mesfushorin e Real Madridit, Casemiro. Lajmin e ka dhënë "Marca", e cila ka njoftuar se "Djajtë e Kuqë" janë duke insistuar për brazilianin. Mesfushori është pjesë kryesiale e planeve të Carlo Ancelottit për sezonin e ardhshëm. Skuadra e Erik ten Hag, pas dështimit të pistës "Frenkie De Jong", i kanë hedhur sytë pikërisht te braziliani. Ish-kampionët anglezë ende nuk kanë nisur ndonjë ofertë për të, mirëpo kjo mund të ndodhë në ditët vijuese.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Cats Recycler” Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin për riciklimin e katalizatorëve në Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.09.2022 në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Misini” në Vushtrri do të organizohet debat publik nga Kompania “Cats Recycler” Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin për riciklimin e katalizatorëve në Vushtrri.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/89740047502?pwd=Q3pzMjZ0V3IHUmRWd3pOM3NxTjJHQT09>

Meeting ID: 897 4004 7502

Passcode: 53ry6v

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “Cats Recycler” Sh.p.k Vushtrri për objektin për riciklimin e katalizatorëve në Vushtrri.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

ANADRINIA MED

SHKOLLA E MESME E LARTË E MIJEKËSISË
PRIZREN

Rr. "TONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë, email: anadriniamed@gmail.com / kbiznesi@gmail.com
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

Bazuar në nenin 15 të Statutit, të SHMILM “ANADRINIAMED” Prizren, Këshilli Drejtues shpallë:

KONKURS

Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë Anadrinia MED shpall konkurs për pranimitë e nxënësve të rinj në klasën e dhjet (X-të), për vitin shkollor 2022/2023

Në drejtimit e licencuar për Arsimin e Mesëm të Lartë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si:

- Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë

Konkursi është i hapur nga date e shpalljes deri me datën 30.08.2022.

Të drejtën e konkurimit e kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë të përfunduar shkollimin e mesëm të nënt dhe të cilët e kanë përfunduar me sukses testin e arritshmërisë.

Dorëzimi i dokumenteve nga kandidatët e interesuar duhet të bëhet në mënyrë fizike në ambientet e shkollës.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet t'i bashkëngjitin aplikacionit:

Certifikatën e kalimit të testit të arritshmërisë për klasat e nënta (origjinale ose kopje të noterizuar);

Diplomën e shkollës së mesme të nënt (origjinale ose kopje të noterizuar);

Dëftesat e shkollës së mesme të nënt (origjinale ose kopje të noterizuar);

Certifikata e lindjes;

Dy fotografi;

Paraqitja e dokumenteve: Rr. "TONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë ose përmes e-mail: anadriniamed@gmail.com / kbiznesi@gmail.com
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Granit Krasniqi shpall të pavlefshme 3 (tri) dëftesat dhe diplomën shmlt “11 Marsi” Prizren .

▶ Efe Refeya shpall të pavlefshme diplomën shmlt “11 Marsi” Prizren.

▶ Shpejtim Bytyci shpall të pavlefshme diplomën shmlt “11 Marsi” Prizren.

▶ Diar Ahmeti shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hoxhë Kadri Prishtina” Prishtinë.

▶ Sami Islami shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të II-(dytë) të shkollës së mesme Medresea “Alauddin” Prishtinë.

▶ Haxhi Sadria nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Bujqësi në Gjakovë.

▶ Anton Nrecaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

▶ Drita Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

▶ Çlirim Berisha nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. “Haxhi Hoti” Rogovë KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

▶ Granit Krasniqi shpall të pavlefshme 3 (tri) dëftesat dhe diplomën shmlt “11 Marsi” Prizren .

▶ Efe Refeya shpall të pavlefshme diplomën shmlt “11 Marsi” Prizren.

▶ Shpejtim Bytyci shpall të pavlefshme diplomën shmlt “11 Marsi” Prizren.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275